

V E N D I M
Nr.517, datë 21.8.1998

**PËR SHQYRTIMIN E PASTËRTISË DHE DHËNIEN E DËSHMISË SË SIGURIMIT
NGA AUTORITETET SHQIPTARE PËR PERSONAT QË DO TË NJIHEN ME
INFORMACIONIN E KLASIFIKUAR TË NATO-S**

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.228, datë 4.4.1998 "Për caktimin e autoritetit kombëtar për shkëmbimin e informacionit me NATO-n", si dhe të marrëveshjes së sigurimit me NATO-n, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Asnjë shtetas shqiptar nuk ka të drejtë të njohë ose të administrojë informacion (dokumentet) të klasifikuar, të shkëmbyer me NATO-n, EAPC-në dhe partneritetin për paqen, nëse nuk është i pajisur me dëshminë e sigurimit.

2. Dhënia dhe heqja e dëshmisë së sigurimit bëhet nga Ministri i Mbrojtjes me propozimin e zyrës së shkëmbimit të informacionit të klasifikuar në Shërbimin Informativ të Ushtrisë dhe mbi bazën e mendimit të bordit vlerësues, i cili përbëhet nga 3 deri në 5 anëtarë, me përbërje nga kundërzbulimi, zbulimi, personeli dhe një jurist, të cilët shqyrtojnë dokumentacionin që paraqet kundërzbulimi.

Sipas kompetencave të hulumtimit të subjektit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Shërbimit Informativ Kombëtar krijohen bordet e vlerësimit si organe konsultative, të cilët japin mendimin e tyre për subjektin që kanë në kompetencë.

3. Afati i vlefshmërisë së dëshmisë së sigurimit është 5 vjet nga data e dhënies. Pas plotësimit të afatit bëhet rivlerësimi i dëshmisë së sigurimit. Dëshmia e sigurimit tërhiqet, kur personi largohet nga detyra, për të cilën i është dhënë dëshmia dhe nuk caktohet në ndonjë detyrë tjetër ku duhet ta ketë.

4. Dëshmia e sigurimit bazohet në shqyrtimin e përshtatshmërisë, në përputhje me standardet dhe kushtet e NATO-s për persona me moshë mbi 18 vjeç, për 10 vitet e fundit nga data e lindjes së nevojës për këtë dëshmi.

5. Verifikimi i së kaluarës dhe gjendjes aktuale, gjyqësore ose procedimit penal i personit bëhet në vend, në të gjithë regjistrat shtetërorë, përfshirë këtu edhe ato të organeve të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Shërbimit Informativ Kombëtar, Shërbimit Informativ të Ushtrisë, dëshmitë e penalitetit, vendimet gjyqësore, gjendjen civile, etj., sipas lejes me shkrim të dhënë nga vetë individi.

6. Verifikimi i së kaluarës dhe gjendjes aktuale të personit, bëhet në përputhje me aktet ligjore, kriteret dhe normat hulumtuese të organeve kompetente të kundërzbulimit, brenda një afati kohor të nevojshëm. Ky afat mund të zgjatet nëse paraqitet nevoja e zgjidhjes dhe sqarimit të problemeve, në lidhje me këtë person.

7. Dhënia e dëshmisë së sigurimit bëhet për ata individë, detyra funksionale e të cilëve e bën të detyrueshme njohjen e këtij lloji informacioni në mënyrë të plotë ose të pjesshme, si dhe për ata individë që në rrethana të caktuara u krijojnë kushte për njohjen me to gjatë kryerjes së shërbimeve të ndryshme ndihmëse (korrierë, postierë, raportues, pajisës, protokollist, sekretar).

Iniciativa për verifikimin e së kaluarës dhe gjendjes aktuale të personit, i cili do të pajiset me dëshminë e sigurimit, përmendur në pikën 4 dhe 5 të këtij vendimi, i takon Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e drejtorisë së Shërbimit Informativ të Ushtrisë, në përputhje me kërkesën e institucionit përkatës.

8. Mbajtësi i dëshmisë së sigurimit për të gjitha informacionet dhe dokumentet e klasifikuara duhet të respektojë rregullat e përgjithshme, rregullat e posaçme ushtarake, si dhe ato të përcaktuara në marrëveshjen me NATO-n, të cilat i bëhen të njohura paraprakisht kundrejt nënshkrimit në çastin e tërheqjes së dëshmisë. Shkelja e këtyre kriterëve përbën shkak për heqjen e dëshmisë përpara afatit, pavarësisht nëse merren ose jo masa të tjera ligjore.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë aktet përkatëse për përcaktimin e standardeve të vlefshmërisë dhe përshtatshmërisë të dëshmisë së sigurimit, të procedurave për verifikimin e personit, të bordit vlerësues, si dhe të standardeve të sigurimit të informacionit të klasifikuar, që shkëmbehet me NATO-n mbi kontrollin e respektimit të tyre, në përputhje me standardet e NATO-s të nivelit sekret dhe konfidencial.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano